

Kronikë nga seanca nr. 45 e KRD-ës

Shkup, 13.09.2013- Këshilli i radiodifuzionit (KRD) në seancën e sotme e miratoi informacionin për pagesën e kompensimit të lejes për ushtrim të veprimtarisë radiodifuzive për emetim tokësor, pas përllogaritjeve të dorëzuara më 29 gusht 2013. SHTR Radio Ravel nga Shkupi në afat të paraparë e plotësoi obligimin ligjor për pagesën e kompensimit për lejen.

KRD e shqyrtoi kërkesën e TV BTR Nacional Shkup për tërheqjen, respektivisht tërheqje nga kërkesa për shqiptimin e veprës penale, e bërë nga Këshilli i radiodifuzionit për emetimin e reklamimit politik në emisionin debativ dhe për shkak të lejimit të limitit për reklamim të paguar politik gjatë kohës së Zgjedhjeve Lokale 2013 dhe konkludoi që të mos e miratoje Kërkesën dhe të mos bëje ankesë kundër gjykimeve në lidhje me shqiptimin e gjobave reale.